

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Erdogan Haxhibeqiri dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit B. Sh. nga Komuna e Lipjanit, të cilin e përfaqëson I. D., av. nga Lipjani, kundër të paditurave Republika e Kosovës-Qeveria e Kosovës, Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Shefqet Hasimi dhe Kuvendi Komunal i Lipjanit, të cilën e përfaqëson F. M., për shkak të kompensimit të paluajtshmërisë, përkitazi me revizionin e të paditurës Qeveria e Kosovës-Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit në Prishtinë, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.563/2013 datë 9.8.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 4.12.2017, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si i pabazuar revizioni i të paditurës Republika e Kosovës-Qeveria e Kosovës, Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit në Prishtinë, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.563/2013 datë 9.8.2017, në pjesën I të dispozitivit e cila ka të bëjë me detyrimin e të paditurës që paditësit t'ia kompensojë patundshmërinë e nxënë me ndërtimin e rrugës Komoran - Caralevë, në shumën prej 22.428 €.

II. Pjesërisht pranohet si i bazuar revizioni i të paditurës Qeveria e Kosovës, Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit në Prishtinë, dhe ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.563/2013 datë 9.8.2017 dhe ai i Gjykatës Komunale (tani Themelore) në Lipjan në pjesën I të dispozitivit, ashtu që detyrohet e paditura Qeveria e Kosovës, Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit në Prishtinë, që paditësit në emër të fitimit të humbur t'ia paguajë shumën prej 130,62 €. Shuma e përgjithshme në pjesën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi të paguhet me kamatë, të cilën e paguajnë bankat afariste në Kosovë në mjetet e

afatizuar mbi një vit pa destinim të caktuar, duke llogaritur nga data 19.5.2012 , nga dita kur është dhënë mendimi i ekspertit dhe në emër të shpenzimeve procedurale shumë prej 980 €, të gjitha në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit, ndërsa kërkesëpadia e paditësit në emër të fitimit të humbur përtej shumës së gjykuar, refuzohet si e pabazuar.

Pjesa II e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk u shqyrtua.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.563/2013 datë 9.8.2017, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës Republika e Kosovës-Qeveria e Kosovës, Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit në Prishtinë, me të cilën është aprovuar kërkesëpadia e paditësit B. Sh. si e bazuar dhe është detyruar e paditura, që paditësit t'ia kompensojë patundshmërinë e nxënë me ndërtimin e rrugës Komoran-Carralevë, në shumë prej 22.428 €, për fitimin e humbur shumë prej 1.045 €, të gjitha në kamatë prej 3,5%, prej datës 15.9.2009, kur është paraqitur padia, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 980 €, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin të përmbarrimit me dhunë. Është refuzuar kërkesëpadia e paditësit, paraqitur kundër të paditurës Kuvendi Komunal në Lipjan, për shkak të mungesës së legjitimacionit pasiv të palës. Gjykata e shkallës së dytë aktgjykimin e cekur e ka ndryshuar vetëm sa i përket kamatës ashtu që ka detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguaj kamatën të cilën e paguajnë bankat në Kosovë sikurse për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar përtej një viti, duke filluar nga data 15.9.2009 e gjer në pagesën defititive.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, e paditura Republika e Kosovës-Qeveria e Kosovës, Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit në Prishtinë, ka paraqitur revizion për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet, ose ato të prishen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të kundërshtuar konform nenit 215 të LPK, ka gjetur se:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësi është pronar i ngastrave kadastrale nr. ..., dhe ..., ndërsa nëpër një pjesë të këtyre ngastrave kadastrale është ndërtuar aksi rrugor Komoran – Caralevë. E paditura Republika e Kosovës-Qeveria e Kosovës, Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit në Prishtinë, me këtë rast nuk ka zhvilluar procedurën e eksproprijimit, ndërsa, sipas ekspertit të gjeodezisë, sipërfaqja e tërësishme e cila i është marrë paditësit është në sipërfaqe prej 3204 m². E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesëpadisë, por vetëm lartësinë e kompensimit dhe ka kërkuar që të llogaritet vetëm sipërfaqja e mbuluar me asfalt duke i përfshirë edhe mbrojtësit anësor të rrugës.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të tërësishëm të gjitha provave ka gjetur se e paditura nuk i është përmbajtur ligjit për eksproprijim, ku paditësit do t'i bëhej kompensimi për pasurinë e patundshme, por duke zbatuar nenin 3 të Ligjit për Eksproprijimin veprimin e të paditurës nuk e ka trajtuar si uzurpim, por si eksproprijim, pasi që në rastin konkret ndërtimi i rrugës paraqet interes të përgjithshëm shoqëror, e pastaj duke u bazuar në mendimin e ekspertëve të gjeodezisë dhe ekspertit të bujqësisë ka vendosur si në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore në tërësi i ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurës dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ndërsa e ka ndryshuar vetëm në pjesën lidhur me caktimin e kamatës.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit që ka të bëjë me detyrimin e të paditurës që paditësit t'ia kompensojë

patundshmërinë e nxënë në shumën prej 22.428 €, është e bazuar. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe ai i gjykatës së shkallës së dytë në këtë pjesë përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike.

Në bazë të nenit 15 par. 1 të Ligjit të shpronësimit, i cili është i aplikueshëm në rastin konkret në bazë të nenit 46 të këtij Ligji, kompensimi për tokën e shpronësuar bëhet në bazë të vlerës së tregut të pronës, e cila caktohet në përputhje me këto dispozita dhe aktet e miratuara në përputhje me par. 6 të këtij neni. Eksperti i bujqësisë inxhi. I dip. A. S., me rastin e caktimit të kompensimit, për tokën e marrë të paditësit, lartësinë e ka caktuar sipas çmimit sipas vlerës së tregut të pronës.

Protokollin 1 neni 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka përcaktuar se ndërhyrja në të drejtat pronësore duhet të jetë e bazuar në ligj ose kjo duhet të jetë masa e fundit e ndërhyrjes për arritjen e qëllimit të paraparë. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 46 par. 1 lejon shpronësimin e pronës private, vetëm nëse është në interesin publik. Sipas kësaj dispozite kushtetuese, shpronësimi mund të bëhet vetëm nëse ai është i caktuar me ligj ose nëse është i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me kompensimin e menjëhershëm dhe adekuat për personin apo të personave prona e të cilëve shpronësohet.

Paditësit, paluajtshmëria kontestuese i është marrë pa u respektuar procedura e shpronësimit dhe atë për nevojat e ndërtimit të rrugës Komoran-Carralevë, për çka e paditura është e obliguar të paguajë kompensimin, të cilën gjykata e shkallës së parë e ka caktuar në pajtim me dispozitat e Ligjit për shpronësimin (Gazeta zyrtare 03/L-139 të Republikës së Kosovës).

Parashtrimet në revizion lidhur me shkeljet e pretenduara të dispozitave të procedurës kontestimore, kjo Gjykatë i vlerësoi si të papranueshme për faktin se shkeljet e tilla nuk janë të saktësuara dhe të arsyetuara në kuptim të ligjit, ndërsa gjykata e revizionit e shqyrton aktgjykimin e goditur brenda kufijve dhe shkaqeve të treguara në revizion (neni 215 të LPK).

Pretendimin se gjykatat e instancës më të ulët, të drejtën materiale e kanë zbatuar në mënyrë të gabuar, Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi si të pabazuar, ngase gjykatat e

instancës më të ulët kanë vlerësuar se e paditura nuk ka respektuar dispozitat e neneve 2, 3, 8, 12, 13 dhe 15 të Ligjit për Eksproprijim, ndërsa bazuar në faktin se çdo pronar, për pasurinë e tij që i bëhet dëm apo që i eksproprijohet, do t'i kompensohet nga shkak i dëmit dhe nga shfrytëzuesi i eksproprijimit. Andaj gjykatat në mënyrë të drejtë kanë zbatuar dispozitën e nenit 154 , 155 dhe 185 par.4 të LMD-ës, për të cilën arsye pretendimi i cekur për zbatimin e gabuar të drejtës materiale u vlerësua si i pabazuar.

Pretendimin e cekur në revizion se eksperti i gjeodezisë mendimin e ka dhënë në bazë të matjeve nga gjendja faktike në teren dhe nuk ka siguruar të dhëna nga Komuna e Lipjanit, Gjykata Supreme e vlerësoi se, një pretendim i tillë ka të bëjë me vërtetimin e gjendjes faktike për të cilën revizioni nuk mund të paraqitet, (neni 214 par.2 të LPK –ës). Përkundër kësaj, kjo Gjykatë shton se me propozimin e të paditurës, eksperti edhe njëherë ka dalë në vendin e ngjarjes për t'ia sqaruar të paditurës mënyrën e matjes, ndërsa e paditura gjatë seancave kryesore mendimin e ekspertëve të gjeodezisë dhe të bujqësisë i ka kundërshtuar në mënyrë të përgjithësuar, por nuk ka kërkuar caktimin e ekspertëve tjerë dhe nuk është deklaruar se për cilat arsye i kundërshton ekspertizat e cekura. Andaj, pretendimi i cekur në revizion se gjykatat e instancës më të ulët nuk i kanë vlerësuar drejt provat dhe lidhur me ekspertizat e cekura më lart, Gjykata Supreme e Kosovës, i vlerësoi si të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë në pjesën që ka të bëjë për shpërblimin e dëmit, në emër të fitimit të humbur, paditësit për mosshfrytëzim të sipërfaqes së marrë prej 0.32,04 ha për periodën për vitet 2004 -2012, është marrë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, ngase sipas dispozitës së nenit 189 par. 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve është përcaktuar se i dëmtuari ka të drejtë në shpërblimin e dëmit të thjeshtë dhe fitimit të humbur. Sipas par. 3 të këtij neni, gjykata gjatë vlerësimit të lartësisë së fitimit të humbur merr parasysh fitimin që ka mundur të pritët sipas rrjedhës së rregullt të sendeve apo rrethanave të veçanta, realizimi i së cilës është penguar në veprimet ose mosveprimet e dëmtuesit. Sipas dispozitës në fjalë të dëmtuarit nuk mund ta pranojnë shpërblimin e dëmit, në emër të fitimit të humbur nëse nuk plotësohet kushtet e caktuara e ato janë: se dëmi në formën e fitimit të humbur është evidente dhe ekzistojnë elementet në bazë të

cilave caktohet fitimi i humbur e që ajo nuk do të ishte në kundërshtim me dispozitat në fuqi dhe doket e mira afariste.

Paditësit i takon shpërblimi i dëmit në emër të fitimit të humbur vetëm për mosshfrytëzim të sipërfaqes prej 0,32,04 ha të paluajtshmërisë së marrë vetëm për vitin 2004, ku ka mundur me pasur shpenzime për tokën bujqësore e jo për vitet tjera në të cilat paditësi nuk ka pasur investime për përgatitjen e tokës për të marrë produktet.

Gjykata nuk e shqyrtoi pretendimin e të paditurës të cekur në revizion lidhur me parashkrimin e kërkesëpadisë, ngase ky pretendim nuk është cekur asnjëherë para gjykatave të instancës më të ulët, ndërsa me revizion sipas nenit 216 të LPK –ës, palët mund të parashtrojnë fakte të reja dhe të propozojnë prova të reja, vetëm nëse ato kanë të bëjnë me shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore të bëra në procedurën e gjykatës së shkallës së dytë.

Gjykata Supreme Kosovës nuk shqyrtoi pjesën II të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, ngase e njëjta nuk u kontestua me revizion.

Nga arsyet e cekura u vendos si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 222 të LPK, ndërsa nën pikën II të dispozitivit në bazë të nenit 224.2. të LPK-së.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Më 4.12.2017, Rev.nr.245/2017

Kryetarja e kolegjit,

Emine Kaçiku